



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.360/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Adnan Konushevci kryesues, Rrustem Thaqi dhe Faton Ademi anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares së lartë ligjore Antigona Murati, duke vendosur përkitazi me ankesën e Institutit Demokratik i Kosovës KDI, me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës AAK, me seli në Prishtinë për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen me datë 14.02.2021, në seancën e panelit të mbajtur me 11.02.2021, mori këtë:

V E N D I M

I. PRANOHET e bazuar ankesa e Institutit Demokratik i Kosovës KDI, me seli në Prishtinë KDI Anr.360/2021 e datës 09.02.2021, ndërsa subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës AAK, me seli në Prishtinë, i shqiptohet dënimimi me gjobë në lartësi prej 1,300.00 (një mijë e treqind) euro, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, me rastin e promovimit te subjektit politik dhe kandidatit të këtij subjekti, duke ngjitur posterat institucionale publike – objektin e hekurudhave, me qëllim të përfshimit elektoral, në fushatë zgjedhore, për zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Kosovës, që do të mbahen me datë 14.02.2021.

II. Detyrohet Subjekti Politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës AAK, me seli në Prishtinë, me seli në Prishtinë, që gjobën e shqiptuar si në pikën -I-, të dispozitivit të këtij vendimi, ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e marrjes së këtij vendimi, nën kërcënim e shqiptimit të dënit shtesë.

A r s y e t i m

Organizata KDI me seli në Prishtinë, ka parashtruar ankesë në PZAP më datë 09.02.2021, me të cilën pretendon se kandidati për deputet nga radhët e subjektit politik AAK, ka vendosur disa poster në objektet e Hekurudhave të Kosovës në Komunën e Ferizajit. Parashtruesi i ankesës pretendon se subjekti politik AAK ka shkelur dispozitat e nenit 33, par 1, pika b, e ligjit për zgjedhjet e përgjithëshme. Si dëshmi ka bashkangjitur fotografin ne formë të printuara nga vendi ku shihen posterët e vendosur në objektet e Hekurudhave të Kosovës.

Në përgjigjen në ankesë të datës 10.02.2021, subjekti politik AAK theksion se kjo ankesë është rast i ngjajshëm me ankesën nr 361-2021, e cila ankesë është ushtruar nga ankuesi i njejt KDI lidhur me pretendimet e ngjajshme kunder subjektit të njejtë AAK, dhe konform nenit 6.3 të rregullave dhe procedurave, kërkojm që të bashkohet ankesa Anr.360-2021 dhe Anr.361-2021 në mënyr që PZAP keto dy ankesa të ngjajshme sikur të ishin një ankesë. Lidhur me të në përgjigjen në ankesë ka paraqitur si provë bashkimin e ankesave me një lënde e cila është vendosur në vendimin Anr.56-2012. Mëtutje në përgjigje pretendon se ankesa Anr.360-2021 që ka të bëje me vendosjen e posterave në rrjetin e Hekurudhave, nga hetimi i zhvilluar dhe nga fotografitë që janë paraqitur si prova nuk kanë mundur që të

identifikojn saktë se në objektin e Hekurudhave kan qenë të vendosur posterat e subjektit politik AAK ashtu siqë pretendohet në ankesë Anr.360-2021. Në vazhdim të përgjigjiës subjekti politik AAK pretendon se parashtruesi i ankesës nuk ka specifikuar datën dhe kohën se kurë ka ndodhur shkelja e supozuar, që kërkonohet sipas dispozitës së nenit 3.4 të rregullave dhe proceduarave të PZAP-it, e në rastin konkret ankuesi nuk e din se kurë është vendosur posterin në atë vend e as kohën se kurë ka ndodhur shkelja e supozuar. Përgjigjiës në ankesë i ka bashkangjitur fotografi pas heqjes së posterave. Propozojë Pzap-i të hedhë poshtë si të pasafatshme ankesën e paraqitur nga “Instituti Demokratik i Kosovës”, me seli në Prishtinë, nëse PZAP gjen se ankesa është ushtruar brenda afatit propozojnë që të refuzohen si të pabazuara.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 par. 2 të LZP-së, gjeti se:

Ankesa është e bazuar

Paneli, nga fotografitë e ofruara si provë nga parashtruesi i ankesës, të cilat gjenden në shkresat e lëndës, në mënyrë të padyshimtë ka konstatuar se kandidati për deputet në Kuvendin e Republikës se Kosovës nga radhët e subjektit politik AAK, ka bërë fushatë zgjedhore duke vendosur posterat në shtyllat elektrike, veprim ky që është në kundërshtim me nenin 33.1 pika b të LZP-së, që përcakton se: ”*Vendosja e njostimeve, pllakateve dhe posterëve, ose përndryshe, vendosja e emrave të tyre ose sloganave në lidhje me fushatën zgjedhore brenda ose jashtë ndërtesave publike ose godinave, në apo mbi rrugët publike*”, të trafikut.

Nga shkresat e lëndës vërtetohet se KDI, me seli në Prishtinë, ka parashtruar ankesë në PZAP, me nr A.nr 360/2021 më datë 09.02.2021, me të cilën pretendon se kandidati për deputet nga radhët e subjektit politik AAK, me qëllim të përfshimit elektoral, në fushatë zgjedhore, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Kosovës, që do të mbahen me datë 14.02.2021, ka vendosur posterat në institucione publike – objektet e hekurudhave.

Pas pranimit të ankesës në PZAP, e njëjtë i është dërguar subjektit politik AAK, për përgjigje në ankesë.

Subjekti politik AAK, me datë 10.02.2021, ka paraqitur përgjigje në ankesë, duke i kundërshtuar në tersi ankuesen e parashtruar si të parregullt dhe të pasafatshme, dhe kërkon nga PZAP-i, që ankesat Anr.360/2021 dhe Anr.361/2021 të datës 09.02.2021, të ushtruara nga ana e KDI-së, të bashkohen në një ankesë të vetme dhe të hudhen poshtë si të pas afatshme.

Duke u nisur nga gjendja e konstatuar faktike Paneli, konstaton se nga provat e ofruara shihet qartë se kandidati i AAK-së, me qëllim të promovimit të subjektit të tij politik dhe vetvetes përmes posterave ka shfrytëzuar objektin e hekurudhave, duke vepruar në kundërshtim me Kodin e Mirësjelljes për Subjektet Politike, Kandidatët dhe Mbështetësit neni 33.1 e LZP-së, ku percaktohet se: ”*Vendosja e njostimeve, pllakateve dhe posterëve, ose përndryshe, vendosja e emrave të tyre ose sloganave në lidhje me fushatën zgjedhore brenda ose jashtë ndërtesave publike ose godinave, në apo mbi rrugët publike, shenja publike të trafikut...*”, duke bërë publik emrin e tij me numrin në listën zgjedhore të subjektit politik AAK, gjë e cila është veprim i ndaluar sipas LPZ-së.

Ky përfundim ka të bëjë me faktin se Kodi i Mirësjelljes i detyron të gjitha subjektet politike, kandidatët, anëtarët e subjekteve dhe mbështetësit e tyre që ta respektojnë këtë kod me qëllim

të krijimit të kushteve që gjatë periudhës së fushatës, veprimet e subjekteve politik të jenë në një atmosferë të tolerancës demokracisë, paqes dhe respektit për sundimin e ligjit.

Pretendimet si në përgjigje në ankesë, se ankesa e parashtruar nga KDI, nuk i përbushë standardet e një ankesë të bazuar në argumente bindëse, nuk qëndrojnë përfaktin se Paneli, konsideron se e njëjtë i plotëson të gjitha kriteret përfundimtare si e rregullt dhe se në përbajtjen e saj është specifikuar edhe koha e shkeljes së kryer nga ana e subjektit politik AAK.

Ndërsa sa i përket pretendimit se përfundimtari rastin e ngjashëm në PZAP, është paraqitur edhe ankesa Anr.361/2021 nga KDI, Paneli konsideron se vendet në të cilat ka ndodhur shkeljet janë të ndryshme, dhe se trajtimin e këtyre ankesave e ka bërë në mënyrë të ndarë përfundimtari shkak se nuk janë plotësuar kushtet përfundimtare bashkuar ankesat sipas nenit 8.3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it.

Paneli, me rastin e vendosjes se gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh të gjitha rrëthanat si në vijim: natyrën e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor në fjalë, shkallën dhe peshën e shkeljes (shkelja është e përsëritur), pjesëmarrjen në proceset e më hershme zgjedhore të subjektit politik Aleanca përfundimtare Ardhmërinë e Kosovës që konsiston në faktin se kandidati përfundimtari deputet nga radhët e këtij subjekti, ka qenë i njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës, dhe se shkeljet e ligeve dhe rregullave zgjedhore në fuqi që ka bërë subjekti në fjalë në këto zgjedhje dhe në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë që do të thotë se i njëjti është i njoftuar me rregullat zgjedhore si dhe shumën e fondeve që ka marrë subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës. Paneli, ka marrë parasysh po ashtu edhe përgjigjen në ankesë të subjektit politik AAK, ku theksohet se posterat janë larguar nga objekti i hekurudhave, andaj kjo i është vlerësuar si ndërmarrje e veprimeve përmirësuese, e cila ka ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptuar si në dispozitiv të këtij vendimi.

Përveç të cekurave më lartë Paneli, me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e subjektit politik Aleanca përfundimtare Ardhmërinë e Kosovës, në kuadër të pretendimeve të theksuara në përgjigje në ankesë, mirëpo të njëjtët ishin jo relevante dhe pa ndikim përfundimtare vendimmarrje ndryshe nga ajo që është vendos.

Nëse subjekti të cilil i është shqiptuar dënim i nuk e paguan të njëjtin brenda afatit të përcaktuar në dispozitiv të tij, atëherë në pajtim me nenin 120.2 të LZP-së, subjektit do ti shqiptohet dënim shtesë. Ky paralajmërim përfundimtare dënim shtesë është përcaktuar me nenin 120.2 të LZP, i cili përcakton: “*120.2 Dështimi përfundimtari për paguar dënimin apo përfundimtari për t'ju bindur një urdhërese të PZAP-it brenda periudhës kohore të saktësuar në vendimin e PZAP-it, është një shkelje tjetër e këtij ligji që mund të sanksionohet me dënim shtesë nga PZAP-i.*”, ashtu siç është vendosur në pikën II të dispozitivit të këtij vendimi.

Paneli, në kuptim të nenit 120.1, pika c), dhe nenit 118.1, të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor përfundimtare
Anr. 360/2021 më datën 11.02.2021

Kryesuesi i Panelit
Adzan Konushevci



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par. 4 të LZP-së.